



RAPORT PËR PUBLIKUN

2022-2024

KESH
ENERGJIA E SHQIPËRISË



PËRMBAJTJA :

FJALA E ADMINISTRATORIT	fq. 4
RRETH NESH	fq. 5
Misioni, Vizioni dhe Strategjia	fq. 5
DREJTIMI I SHOQËRISË	fq. 5
Asambleja e Përgjithshme	fq. 5
Këshilli Mbikëqyrës	fq. 5
BURIMET NJERËZORE	fq. 6-8
STRUKTURA ORGANIZATIVE	fq. 9-10
FAKTE DHE SHIFRA	fq. 12-13
Të dhëna të përgjithshme Aktiviteti 2022-2024	fq. 12
Kapacitetet Gjeneruese dhe Prodhimi 2022-2024	fq. 12-13
ÇFARË BËJMË	fq. 14-18
Kaskada e Drinit	fq. 14
HEC Fierzë	fq. 15
HEC Koman	fq. 16
HEC Vau i Dejës	fq. 17
TEC Vlorë	fq. 18
Impianti PV Diga e Qyrsaqit	fq. 18
TEC lundruës Vlorë	fq. 18
INVESTIMET DHE DIVERSIFIKIMI I ENERGJISË 2022-2024	fq. 19-20
Projekti HEC Skavica	fq. 19
Impiante Fotovoltaike	fq. 19-20
TREGUESIT E PERFORMANCËS 2022-2024	fq. 21-28
Shfrytëzimi i Burimeve	fq. 21
Aktiviteti i Tregtisë së Energjisë	fq. 22-24
Realizimi i Investimeve	fq. 24
Fokusi i investimeve sipas fushave	fq. 25
Burimet e financimit të investimeve	fq. 25-26
Roli i Partnerëve Ndërkombëtarë	fq. 26-27
Dimensioni Social – Mjedisor	fq. 27-28
TREGUESIT EKONOMIKO-FINANCIAR	fq. 29-30

FJALA E ADMINISTRATORIT

Të nderuar qytetarë, partnerë dhe bashkëpunëtorë,

Tre vitet e fundit kanë përfaqësuar një periudhë dinamike për Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), të karakterizuar nga sfida komplekse dhe arritje domethënëse. Me Raportin Publik 2022–2024, paraqesim një pasqyrë të qartë mbi rezultatet e punës sonë, vendimmarrjet strategjike, projektet inovative dhe përkushtimin tonë për garantimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike për çdo konsumator.

Pavarësisht kushteve hidrike shpesh të paparashikueshme, KESH ka menaxhuar me përgjegjësi prodhimin, importet dhe rezervat ujore, duke siguruar vazhdimësinë e furnizimit me energji të sigurt dhe me kosto të përballueshme për familjet, bizneset dhe institucionet në të gjithë vendin. Ky është një mision i rëndësishëm që e konsiderojmë si detyrim ndaj shoqërisë.

Gjatë kësaj periudhe kemi ndërmarrë hapa të qëndrueshëm për të ardhmen: forcimin e sigurisë së kaskadës së Drinit, ngritjen e sistemeve bashkëkohore të monitorimit, investime në kapacitete diellore dhe promovimin e burimeve të reja të energjisë së pastër. Këto veprime përbëjnë jo vetëm investime teknike, por edhe garanci për një sektor energjetik më të gjelbër dhe të qëndrueshëm në afatgjatë.

KESH mbetet një aktor i pandarë i komuniteteve ku operon, duke kontribuar në nisma sociale dhe mjedisore që tregojnë se zhvillimi ekonomik dhe mbrojtja e mjedisit ecin paralelisht.

Ky raport është një shprehje e angazhimit tonë për transparencë dhe llogaridhënie. Ky raport dëshmon rolin e KESH si shtyllë themelore e sektorit energjetik shqiptar dhe partner i besueshëm në nivel kombëtar si dhe rajonal. Sfida të reja na presin, por vizioni ynë mbetet i qartë: ndërtimi i një të ardhmeje energjetike të pastër, të sigurt dhe të qëndrueshme për të gjithë. Me respekt e mirënjohje,

Erald Elezi
Administrator
Korporata Elektroenergjetike Shqiptare

RRETH NESH

Misioni, Vizioni dhe Strategjia

MISIONI

KESH ka për mision të prodhojë energjinë e së nesërme në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe inteligjente, me ndikim minimal në mjedis. Shoqëria synon të rrisë kompetencat e punonjësve dhe besimin e tyre si pjesë e saj, të orientohet drejt zhvillimit të tregut dhe komercializimit, si dhe të garantojë shfrytëzimin racional dhe mirëmbajtjen efektive të aseteve prodhuese. Rritja e vazhdueshme e kërkesës për energji e bën të domosdoshme zgjerimin e burimeve dhe të kapaciteteve prodhuese.

VIZIONI

KESH synon të bëhet një aktor i rëndësishëm në tregun rajonal të energjisë, duke diversifikuar burimet e saj të rinovueshme, duke sjellë produkte dhe shërbime të reja dhe duke forcuar rolin e Shqipërisë si një partner i besueshëm në sektorin energjetik.

STRATEGJIA

Shoqëria KESH sh.a. synon të ruajë dhe të konsolidojë pozitën e saj në prodhimin e energjisë elektrike në Shqipëri duke u përshtatur me ndryshimet e tregut, zhvillimet teknologjike, mundësitë për financim dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. Në këtë kuadër, veprimtaria e saj orientohet drejt përmirësimit të vazhdueshëm të performancës, rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe forcimit të kulturës së transparencës dhe mirëqeverisjes. KESH vepron

me ndershmëri, besueshmëri dhe respekt ndaj punonjësve, partnerëve dhe palëve të interesuara. Shoqëria mbetet e përkushtuar ndaj zhvillimit të qëndrueshëm dhe ushtron veprimtarinë e saj me përgjegjësi të lartë sociale dhe mjedisore, duke kontribuar në sigurimin e një të ardhmeje energjetike të pastër dhe të besueshme.

DREJTIMI I SHOQËRISË

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme, bazuar në nenin 135 e vijues të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar si edhe të statutit të KESH sh.a., është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë KESH sh.a. dhe përfaqësohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Këshilli Mbikëqyrës

Në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Vendimit Nr.570, date 3.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, numri i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të KESH sh.a., si shoqëri pjesë e sektorëve strategjikë do të jetë 6 (gjashtë). Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të KESH sh.a., emërohen në detyrë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

Shoqëria KESH sh.a është shoqëri aksionare me kapital të zotëruar 100% nga Shteti Shqiptar (përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) sipas aktit të themelimit datë 17.10.1995, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me Vendimin Nr. 12728, datë 06.11.1995.


BURIMET NJERËZORE

Kapitali njerëzor përbën një nga asetet më të rëndësishme dhe jetike të Shoqërisë, ndaj politikat strategjike janë të orientuara drejt vlerësimit, zhvillimit profesional dhe përzgjedhjes së punonjësve me kualifikimet dhe eksperiencën e nevojshme, në përputhje me kërkesat e çdo pozicioni të punës. Aseti njerëzor është elementi dallues që kontribuon në rritjen e cilësisë, efikasitetit dhe imazhit të Shoqërisë në funksion të arritjes së objektivave të saj.

Falë njohurive, aftësive dhe motivimit të tyre, punonjësit përbëjnë forcën lëvizëse dhe motorike të Shoqërisë. Menaxhimi i suksesshëm i burimeve njerëzore mbështetet në harmonizimin e objektivave individuale me objektivat institucionale, duke krijuar një kulturë bashkëpunimi dhe përkushtimi të përbashkët ndaj misionit të Shoqërisë.


BALANCA GJINORE

BALANCA GJINORE TOTALE (%)



Në Korporatë mbizotërojnë punonjësit meshkuj me 73%, krahasuar me 27% femra, dhe kjo e theksuar më tepër në kategorinë inxhiniero-teknik në HEC-e. Ky trend është në përmirësim, pasi para 2022, ky raport qëndronte 77% meshkuj dhe 23% femra, duke synuar një balancë gjinore më të

BALANCA GJINORE E STAFIT DREJTUES (%)




drejtë dhe rritjen e rolit të femrave në Korporatë. Në segmentin e stafit drejtues të Korporatës është për tu evidentuar rritja e rolit të femrave, me një përbërje prej 45%, ndërsa meshkujt 55%, duke përmirësuar ndjeshëm këtë tregues, i cili para 2022 qëndronte 62% meshkuj dhe 38% femra.

BURIMET NJERËZORE


STATISTIKA STRUKTURE TË PERSONELIT

MOSHA MESATARE E STAFIT (vjeç)




Korporata aktualisht ka një moshë mesatare të personelit rreth 47 vjeç, me tendencën për ulje si në total ashtu edhe për të dyja gjinitë. Në pikëpamjen strukturore të gjeneratave, Gjeneratat X dhe Millennials përbëjnë pjesën dërrmuese me

STRUKTURA E STAFIT SIPAS GJENERATAVE




83% të kapitalit njerëzor, ndërkohë që gjenerata Baby Boomers po shkon drejt uljes duke ia kaluar stafetën brezave të rinj, duke shfaqur gjeneratën Z.

NIVELI ARSIMOR SIPAS GJINISË (%)



Punonjësit me arsim të lartë përbëjnë 55% të totalit, me trend rritës, pasi para 2022 ky tregues ishte 51%. Korporata synon rritje të këtij segmenti, duke rekrutuar profesionistë të fushave inxhinierike,


Niveli Arsimit i Stafit (%)



ekonomiko-financiare, juridike, social-mjedisore etj. Për tu evidentuar është niveli i lartë i femrave me arsim të lartë, që përbën 85% e totalit të femrave.

BURIMET NJERËZORE

MOSHA MESATARE SIPAS GJINISË DHE ARSIMIT (vjeç)





POLITIKA DHE BENEFITE


Menaxhimi i burimeve njerëzore ka qenë gjithmonë një nga prioritetet kryesore të Korporatës, duke synuar jo vetëm përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë profesionale të stafit, por edhe përzgjedhjen e individëve me integritet dhe aftësi për të përqaftuar vlerat dhe parimet mbi të cilat funksionon institucioni. Kjo e bën Korporatën një ambient pune të qëndrueshëm, të bazuar në respekt, korrektësi dhe bashkëpunim në skuadër. Si objektiv strategjik i zhvillimit, rëndësi të veçantë i kushtohet rritjes profesionale të punonjësve përmes një game të larmishme trajnimesh, që variojnë nga ato orientuese për punonjësit e rinj deri tek ato tekniko-profesionale, të përshtatura sipas pozicioneve dhe fushave specifike të ekspertizës.

Korporata i kushton vëmendje të vazhdueshme paketës së benefiteve për punonjësit, ku përfshihen sigurimi shëndetësor dhe ndaj aksidenteve, si dhe fondi i pensionit vullnetar, të cilat reflektojnë përkujdesjen e saj afatgjatë ndaj stafit. Gjithashtu, një komponent thelbësor mbetet vlerësimi i performancës, i cili shërben si tregues i ecurisë së punonjësve dhe ofron informacion të vlefshëm për realizimin e detyrave, produktivitetin, nevojat për trajnim dhe zhvillim, si dhe për motivimin dhe shpërblimin. Ky proces ndihmon në identifikimin dhe menaxhimin e talenteve, bazuar në rezultatet e arritura dhe objektivat e përcaktuara nga menaxhimi.





Struktura Organizative




FAKTE DHE SHIFRA

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) është prodhuesi publik dhe njëkohësisht prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në vend.

- KESH zotëron një kapacitet total të instaluar gjenerues prej 1,563 MW.
- Me një fuqi hidrike të instaluar prej 1,350 MW, KESH është prodhuesi më i madh i energjisë hidrike jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajonin e Ballkanit.
- Korporata zotëron mbi 69% të kapaciteteve të instaluar gjeneruese të lidhura në rrjetin kombëtar të transmetimit dhe 49% të totalit të kapaciteteve kombëtare prodhuese të energjisë elektrike.
- KESH siguron rreth 56% të prodhimit kombëtar të energjisë elektrike dhe mbulon rreth 57% të konsumit vendas.
- Krahas rolit themelor në gjenerimin e energjisë dhe garantimin e furnizimit publik kombëtar, KESH mban përgjegjësi kyçe edhe për sigurinë e funksionimit teknik të sistemit elektroenergjetik nëpërmjet ofrimit të shërbimeve ndihmëse dhe mekanizmave të balancimit.
- Kaskada e Drinit, që prej vënies së saj në operim të plotë në vitin 1986, ka prodhuar gjithsej 159,834 GWh deri në vitin 2024, me kontribute të detajuara sipas secilit HEC.

Prodhimi Kaskada Drinit - Operativiteti i Plotë 1986-2024 (GWh & %)



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Aktiviteti: 2022-2024

• Totali i Aktiviteve	174 Mld. Lek
• Aktivitet Afatgjatë Materiale	82.4 Mld. Lek
• Energji e qarkulluar mesatare vjetore (2022-2024)	6,544,762 MWh
• Të ardhura mesatare vjetore (2022-2024)	35.7 Mld. Lek
• Shitje mesatare vjetore energji elektrike (2022-2024)	31.8 Mld. Lek
• Blerje mesatare vjetore energji elektrike (2022-2024)	30.7 Mld. Lek
• Fitimi neto maksimal (2023)	13.5 Mld. Lek
• Investimet totale (2022-2024)	10.3 Mld. Lek
• Nr. i punonjësve	723 punonjës

Kapacitetet Gjeneruese dhe Prodhimi 2022-2024


Aktualisht, KESH sh.a. disponon një fuqi totale të instaluar prej 1,563 MW, e cila shpërndahet : 86.4% nga burimet hidrike, 13.3% nga termocentralet dhe 0.3% nga panelet fotovoltaike.

- HEC i Fierzës, fuqi të instaluar 500 MW (4 turbina x 125 MW);
- HEC i Komanit, fuqi të instaluar 600 MW (4 turbina x 150 MW);
- HEC i Vaut të Dejës, fuqi të instaluar 250 MW (5 turbina X 50 MW);
- TEC i Vlorës, fuqi të instaluar 98 MW (70 MW+28 MW), i cili nuk është në funksion;
- TEC Lundrues i Vlorës, fuqi e instaluar 110 MW (50 MW + 60 MW);
- Impianti PV i digës së Qyrsaqit - HEC Vau i Dejës, fuqi e instaluar 5,14 MW.

FAKTE DHE SHIFRA

Struktura gjeneruese e instaluar, paraqitet në vijim:


Kapacitetet Gjeneruese të Instaluar KESH sh.a. (MW)



Prodhimi 2022-2024

- Totali i Prodhimit (2022-2024) 13,224 GWh;
- Prodhimi mesatar vjetor (2022-2024) 4,408 GWh;
- Prodhimi maksimal vjetor 5,175 GWh, viti 2023;
- Prodhimi minimal vjetor 3,896 GWh, viti 2022.

Prodhimi Bruto i KESH (2022-2024)



ÇFARË BËJMË?

KESH sh.a. është prodhuesi kryesor i energjisë elektrike në Shqipëri dhe një aktor strategjik për garantimin e sigurisë energjetike kombëtare. Shoqëria mbulon mbi gjysmën e prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike në vend, duke administruar kaskadën e Drinit. Ky zinxhir i integruar liqenesh dhe digash, unik në Europë, siguron rreth 69% të kapaciteteve të instaluar të lidhura me rrjetin kombëtar të transmetimit.

Kaskada e Drinit

KESH sh.a. menaxhon kaskadën më të madhe hidroenergjetike në rajon, duke siguruar prodhimin e energjisë elektrike nga lumi Drin. Sipërfaqja ujëmbledhëse e këtij lumi shtrihet në 14,173 km², me një gjatësi totale të rrjedhës prej 285 km, dhe Drini mbetet lumi më i gjatë në territorin shqiptar, me 160 km brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë.

Në pjesën veriore të vendit, lumi Drin ka formuar një zinxhir liqenesh artificiale, duke përfshirë Liqenet e Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës. Në shtratin e tij janë ndërtuar hidrocentralet e Fierzës, Komanit, Vaut të Dejës dhe Ashtës, me një fuqi totale të instaluar prej 1,400 MW. Tre hidrocentralet e para, më të fuqishmet, administrohen nga KESH dhe kanë një kapacitet të instaluar prej 1,350 MW.

Kaskada e Drinit është e veçantë në Europë për kombinimin e lartësisë së digave, llojit të tyre, liqeneve që krijon, fuqisë së instaluar të hidrocentraleve dhe menaxhimit operacional të tyre. Sipas rrjedhës së lumit Drin, hidrocentralet e KESH-it janë:

- **Hidrocentrali i Vaut të Dejës**, i cili filloi prodhimin në vitin 1971, me një fuqi të instaluar prej 250 MW.
- **Hidrocentrali i Fierzës**, i cili filloi prodhimin në vitin 1978, me një fuqi të instaluar prej 500 MW.
- **Hidrocentrali i Komanit**, i cili filloi prodhimin në vitin 1985, me një fuqi të instaluar prej 600 MW.

Të dhëna historike gjenerimi të Kaskadës

- Prodhimi Total energji elektrike i KESH (1971- 2024) **181,285 GWh**
- Rekordi i prodhimit vjetor – viti 2010 **7,053 GWh**
- Prodhimi vjetor minimal – viti 1990 **2,511 GWh**
- Prodhimi mesatar historik vjetor (1971-2024) **3,357 GWh**
- Prodhimi mesatar vjetor në operativitet te plotë (1986-2024) **4,098 GWh**

Treguesit e Aktivitetit Ekonomik	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022	Mesatarja 5-vjeçare (2020-2024)
Energjia Neto e Prodhuar nga KESH sh.a (GWh)	4,115	5,131	3,860	4,308
Të Ardhura ('000 Lekë) ¹	26,288,770	38,366,097	36,609,329	26,307,104
Energji elektrike ('000 Lekë)	20,130,182	32,519,044	29,944,816	20,498,939
Shërbimet ndihmëse dhe të balancimit ('000 Lekë)	4,898,832	4,623,231	5,260,934	3,847,334
Të ardhura të tjera ('000 Lekë)	1,259,757	1,223,823	1,403,579	1,960,831
Fitimi / (Humbja) neto për periudhën ('000 Lekë)	-378,718	17,053,377	-25,818,100	-210,568
Llogari të Pagueshme ('000 Lekë)	6,142,813	22,801,193	25,332,173	26,364,082
Llogari të Arkëtueshme ('000 Lekë)	64,226,152	75,745,231	72,685,314	66,547,605
Shpenzimet Fikse Operacionale ('000 Lekë) ²	2,355,998	2,311,134	2,295,441	2,246,024
Shpenzime Operative ('000 Lekë/GWh)	573	450	595	539

ÇFARË BËJMË?

HEC Fierzë

Hydrocentrali i Fierzës është hidrocentrali i sipërm i kaskadës së lumit Drin dhe ka një rol kyç në shfrytëzimin, rregullimin hidrik dhe sigurinë e të gjithë kaskadës së Drinit, për shkak të fuqisë së instaluar, pozicionit strategjik dhe vëllimit të rezervuarit.

HEC Fierza është një hidrocentral i tipit digë-rezervuar. Diga është e ndërtuar me mbushje gurësh dhe bërthamë argjile, me një lartësi prej 161,5 m dhe një gjatësi prej 380 m. Gjerësia e digës varion nga 576 m në bazament deri në 13 m në kreshtën e saj. Kur u ndërtua, diga e Fierzës ishte e dyta më e lartë e këtij lloji në Europë, me një volum total prej 8 milionë m³.

Kjo digë ka krijuar një rezervuar artificial me një volum prej 2,7 miliardë m³ ujë dhe një sipërfaqe prej 2 km², duke e bërë Liqenin e Fierzës liqenin artificial më të madh në vend. Vëllimi i shfrytëzueshëm i rezervuarit është 2.3 miliardë m³. HEC Fierza është klasifikuar si vepër e klasit të parë për sa i përket rrezikshmërisë.

Të dhëna teknike HEC Fierzë:

- Fuqia Totale e instaluar **4 x 125 = 500 MW;**
- Numri i Turbinave /Tipi **4 turbina "Francis" vertikale;**
- Volumi i digës **8 Mln. m³;**

- Nivel i Maksimal i ujit **296 mmnd;**
- Nivel minimal i operimit **240 mmnd;**
- Vëllimi total i liqenit **2.7 Mld. m³;**
- Vëllimi operacional i liqenit **2.3 Mld. m³.**


Të dhëna operationale gjeneruese HEC Fierzë:

- Prodhimi total historik (1978-2024) **62,130 GWh;**
- Prodhimi vjetor mesatar (1978-2024) **1,322 GWh;**
- Nivel mesatar i shfrytëzimit (2009-2024) **282.6 m;**
- Prodhimi maksimal viti 2010 **2,669 GWh;**
- Prodhimi minimal viti 1990 **639 GWh;**
- Kontributi historik kaskada (1971-2024) **34%**
- Kontributi kaskada e plotë (1986-2024) **33%**

Prodhimi 2022-2024 HEC Fierzë:

- Prodhimi Total **4,223 GWh;**
- Prodhimi Mesatar Vjetor **1,408 GWh.**

Prodhimi HEC Fierzë 2022-2024 (GWh)



ÇFARË BËJMË?

HEC Koman

Hidrocentrali i Komanit është hidrocentrali i dytë dhe më i fuqishëm i kaskadës së lumit Drin. Për shkak të fuqisë së instaluar, pozicionit strategjik dhe vëllimit të rezervuarit, HEC Koman luan një rol kyç në prodhimin dhe shfrytëzimin e të gjithë kaskadës. Ky hidrocentral është gjithashtu impianti me fuqinë më të madhe të instaluar në vend për prodhimin e energjisë elektrike.

HEC Koman është i tipit digë-rezervuar. Diga ka një konstruktim të kombinuar me mbushje gurësh dhe një ekran betonarme, me një lartësi prej 133 m dhe gjatësi 290 m. Diga e Komanit renditet ndër 10 digat më të larta të këtij lloji në Evropë, me një volum total prej 5 milionë m³.

Rezervuari i krijuar nga diga ka një vëllim total prej 500 milionë m³ ujë, nga të cilat 188 milionë m³ janë të shfrytëzueshme për prodhimin e energjisë.

Të dhëna teknike HEC Koman

- Fuqia Totale e instaluar **4 x 150 = 600 MW;**
- Numri i Turbinave /Tipi **4 turbina "Francis" vertikale;**
- Volumi i digës **5 Mln. m3;**

- Niveli Maksimal i ujit **175.5 mmnd;**
- Niveli minimal i operimit **160 mmnd;**
- Vëllimi total i liqenit **0.5 Mld. m3;**
- Vëllimi operacional i liqenit **0.19 Mld. m3.**


Të dhëna historike gjenerimi të Kaskadës

- Prodhimi total historik (1985-2024) **71,308 GWh;**
- Prodhimi vjetor mesatar (1985-2024) **1,783 GWh;**
- Niveli mesatar i shfrytëzimit (2009-2024) **172.4 m;**
- Prodhimi maksimal - viti 2010 **2,873 GWh;**
- Prodhimi minimal - viti 2007 **1,200 GWh;**
- Kontributi historik kaskada (1971-2024) **39%**
- Kontributi kaskada e plotë (1986-2024) **45%**

Prodhimi 2022-2024 HEC Koman:

- Prodhimi Total **5,944 GWh;**
- Prodhimi Mesatar Vjetor **1,981 GWh.**

Prodhimi HEC Koman 2022-2024 (GWh)



ÇFARË BËJMË?

HEC Vau i Dejës

Hidrocentrali i Vaut të Dejës është hidrocentrali i parë që u ndërtua mbi lumin Drin dhe ndodhet në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë, në rrjedhën e poshtme të lumit, në grykën e Vaut të Dejës, rreth 18 km nga qyteti i Shkodrës. Duke qenë hidrocentrali më i poshtëm me digë dhe liqen në kaskadën e Drinit, rëndësia e tij shtrihet përtej prodhimit të energjisë elektrike, pasi liqeni i Vaut të Dejës ndikon në ultësirën e nën-Shkodrës. HEC Vau i Dejës është i tipit digë-liqen. Vëllimi maksimal i liqenit arrin 580 milionë m³, me një sipërfaqe prej 25 km², dhe shtrihet nga gryka e Vaut të Dejës për rreth 27 km në luginën e lumit Drin, deri në afërsi të hidrocentralit të Komanit. Niveli maksimal i lejuar i ujit në liqen është 76 m mbi nivel deti, ndërsa niveli minimal i operimit është 61 m mbi nivel deti. Vëllimi aktiv i liqenit është 263 milionë m³ ujë.

Si pjesë e kaskadës së Drinit, HEC Vau i Dejës është klasifikuar si vepër e klasit të parë për sa i përket nivelit të rrezikut.

Të dhëna teknike HEC Vau i Dejës:

- Fuqia Totale e instaluar **5 x 50 = 250 MW;**
- Numri **5 turbina "Francis" vertikale;**
i Turbinave /Tipi
- Volumi i digave **3.5 Mln. m3;**

- Niveli Maksimal i ujit **76 mmnd;**
- Niveli minimal i operimit **61 mmnd;**
- Vëllimi total i liqenit **0.58 Mld. m3;**
- Vëllimi operacional i liqenit **0.26 Mld. m3.**


Të dhëna operationale gjeneruese HEC Vau i Dejës:

- Prodhimi total historik (1971-2024) **47,847 GWh;**
- Prodhimi vjetor mesatar (1971-2024) **886 GWh;**
- Niveli mesatar i shfrytëzimit (2009-2024) **74 m;**
- Prodhimi maksimal viti 2010 **1,511 GWh;**
- Prodhimi minimal viti 1975 **611 GWh;**
- Kontributi historik kaskada (1971-2024) **26%**
- Kontributi kaskada e plotë (1986-2021) **23%**

Prodhimi 2022-2024 HEC Vau i Dejës:

- Prodhimi Total **3,017 GWh;**
- Prodhimi Mesatar Vjetor **1,006 GWh;**

Prodhimi HEC Vau i Dejës 2022-2024 (GWh)



ÇFARË BËJMË?

TEC i Vlorës

Termocentrali i Vlorës (TEC Vlorë) ka një kapacitet të instaluar prej 98 MW, i përbërë nga dy turbina (90 MW + 28 MW), dhe funksionon me karburant fosil. Ky termocentral u ndërtua për të përmbushur nevojat e vendit për shtimin e burimeve prodhuese, duke ofruar gjenerim termoelektrik me qëllim zvogëlimin e varësisë nga prodhimi hidroelektrik dhe përqendrimi i burimeve kryesore energjetike në pjesën veriore të vendit.

Në janar 2012, një defekt në tubacionin e ujit, që shërben për ftohjen e turbinës, ka bërë që impianti të ndalojë funksionimin. Aktualisht, TEC Vlorë ndodhet në gjendje konservimi. KESH sh.a. po zbaton një plan masash për rivënien e tij në punë, duke shqyrtuar edhe opsionin e transformimit të gjenerimit nga nafta në gaz.

Impianti PV Diga e Qyrsaqit

Impianti Fotovoltaik (PV) Diga e Qyrsaqit filloi aktivitetin gjenerues më 12 Shkurt 2022. Me një fuqi të instaluar prej 5,143 MW, ky impiant, i vendosur mbi digën e Qyrsaqit – pranë HEC Vaut të Dejës, përfaqëson burimin e parë të energjisë së diversifikuar që i shtohet portofolit gjenerues të Shoqërisë.

Ndërtimi i impiantit fotovoltaik u financua nga fondet e vetë Korporatës dhe përbën një arritje të rëndësishme për Shoqërinë. Ky projekt kontribuon në realizimin e objektivit afatgjatë të zhvillimit, duke rritur kapacitetet gjeneruese nëpërmjet diversifikimit të burimeve të energjisë.

Të dhëna teknike:

- Fuqia e instaluar **5.143 MWp;**
- Rrezatimi mesatar diellor **1,562 kWh/m2;**

- Numri i njësive gjeneruese **12,544 copë;**
- Kapaciteti/njësi gjeneruese **410 Wp;**
- Faktori i efikasitetit prodhuese **15.5%;**
- Prodhimi i projektuar viti I-rë **6,987 MWh;**
- Jetëgjatësia operative **25 vite;**
- Prodhimi total i parashikuar **164,200 MWh.**
25 vite

Prodhimi 2022-2024 Impianti PV Diga Qyrsaq

- Prodhimi Total **16.9 GWh;**
- Prodhimi Mesatar Vjetor **5.63 GWh;**

TEC lundruer Vlorë

Termocentrali lundruer në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës, ka një fuqi totale të instaluar prej 110 MW dhe përbëhet nga dy njësi gjeneruese: “Tigri 1” me kapacitet 50 MW dhe “Tigri 3” me kapacitet 60 MW. Njësitë gjeneruese përfshijnë gjithsej 19 gjeneratorë për prodhimin e energjisë elektrike.

Ky termocentral lundruer ka një rol të rëndësishëm në gjenerimin e energjisë në situata emergjence, duke ofruar mbështetje gjatë krizave energjetike globale dhe duke reduktuar varësinë nga importi i energjisë me çmime të larta. Ai shërben gjithashtu si një burim gjenerimi gjatë periudhave të thatësirës, kur prodhimi hidroelektrik pakësohet ndjeshëm, duke garantuar siguri të shtuar në prodhimin e energjisë elektrike të nevojshme për furnizimin e vendit.

INVESTIMET DHE DIVERSIFIKIMI I ENERGJISË 2022-2024

Projekti HEC Skavica

Projekti i HEC Skavica është një nga projektet më të rëndësishëm në prodhimin e energjisë elektrike i cili do të ketë ndikim të madh në sektorin elektro-energjetik jo vetëm në Shqipëri por edhe në vendet e rajonit. Projekti është konceptuar të shfrytëzojë potencialin hidroenergjetik të lumit Drin i Zi (degë e Drinit të madh) që ndodhet brenda kufirit të territorit Shqiptar. Realizimi i këtij projekti do të konsolidojë ndjeshëm pozicionin e Korporatës si lider në prodhimin e energjisë në vend por edhe me ndikim të rëndësishëm dhe konkurrues rajonal.

Faza I e kontratës me Kompaninë Bechtel përfshin ESIA+Basic Design+Studim Fisibiliteti. Sipas parashikimit pritët përfundimi i aktiviteteve të Fazës I dhe më pas të fillojnë përgatitjet për Fazën II të kontratës. Po kështu gjatë 2024 është përzgjedhur këshilltari financiar i cili do të konsultojë KESH, në lidhje me fushën ekonomiko-financiare të projektit. Faza e II e projektit parashikohet të vijohet në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 38/2021. Bazuar në vlerësimet e rezultateve të Fazës I, parashikohet që Faza II të përfshijë etapat e projektimit të detajuar+kontrata e ndërtimit+zbatimi i projektit.

Impiante Fotovoltaike

Si objektiv i rëndësishëm i zhvillimit strategjik dhe të qëndrueshëm të Korporatës është edhe rritja e kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet burimeve të diversifikuara. Kjo strategji e ndjekur nga Korporata është në linjë me politikat dhe strategjitë kombëtare të vendosura nga Qeveria Shqiptare, dhe dokumentat strategjik të brendshëm si Plani i Menaxhimit ndaj Riskut të Ndryshimeve Klimatike, Strategjia për Zhvillimin e

KESH sh.a. (Strategy in Action), Zhvillimi Strategjik i Sektorit Energjetik etj. Aktiviteti i Korporatës për shtimin e diversifikuar të kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, është fokusuar më së shumti tek energjia diellore.

- **Projekti për ndërtimin e impiantit fotovoltaik lundrues 13.8 MWp në liqenin e ViD:**

Impianti parashikon një prodhim mesatar vjetor të energjisë elektrike prej rreth 18,000 MWh, duke rezultuar me një koeficient të kënaqshëm efieience prodhimi për këtë teknologji prej 15.5%.

Zhvillimi i këtij projekti po realizohet në bashkëpunim të ngushtë me BERZH, e cila ka lidhur marrëveshjen e angazhimit për financimin e këtij projekti nëpërmjet një kredie tregtare. Po kështu është nënshkruar marrëveshja e kredisë ndërmjet kompanisë së projektit SENA sh.a., sponsorit KESH sh.a. dhe BERZH. Në fund 2024 është firmosur kontrata me zbatuesin e projektit, bashkimin e kompanive ndërkombëtare për realizimin e këtij projekti Gamma-SunGrow. Projekti është në fazën projektimit të detajuar teknik dhe më pas zbatimi.

- **Projekti për ndërtimin e impiantit fotovoltaik 8.25 MWp në digën e Zadejës të HEC ViD:**

Projekti parashikon një prodhim mesatar vjetor të energjisë elektrike prej rreth 10,400 MWh, duke rezultuar me një koeficient të kënaqshëm efieience prodhimi për këtë teknologji prej rreth 15.5%.

Ashtu si impianti PV i në digën e Qyrfaqit, impianti PV i Zadejës do të instalohet mbi sipërfaqen e digës së Zadejës të HEC Vau i Dejës. Impianti financohet

INVESTIMET DHE DIVERSIFIKIMI I ENERGJISË 2022-2024

me fondet e KESH sh.a. Aktualisht projekti i impiantit të Zadejës është në fazën e ndërtimit të veprës i cili pritet të përfundoj në mesin e 2026. Objektivat dhe rëndësia e këtij projekti janë të njëjta me projektin e impiantit fotovoltaik në digën e Qyrsaqit.

- Ky është një projekt në shkallë të gjerë dhe me impakt që synon diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike. Impianti parashikon një prodhim vjetor rreth 79,000 MWh me një koeficient të kënaqshëm efieçence prodhimi për këtë teknologji dhe zonën e rrezatimit prej 16%.

Në fillim të 2024 përfundoi procesi i studimit të fizibilitetit nga kompania Tractebel Engineering

GmbH. Gjithashtu Tractebel ka përgatitur Basic Electrical Design, si dhe Minimum Functional Specifications si pjesë e specifikimeve teknike për tenderim. Aktualisht është nënshkruar kontrata e financimit me kredi me BERZH, me terma preferencial (garanci sovraane) si dhe marrëveshja e grantit për asistencë teknike për realizimin e studimeve dhe projektit teknik. Projekti ka fituar në programin e WBIF-EIP grant për investimin, i cili është alokuar në Prill 2024. Viti 2025, parashikon përfundimin e fazës para-ndërtimore.


TREGUESIT E PERFORMANCËS 2022-2024

Shfrytëzimi i Burimeve

Prurjet dhe Prodhimi	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022	Mesatarja 15 vjeçare
Prurjet mesatare në Fierzë (m³/sek)	140	196	172	189
<i>Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)</i>	74.1%	103.7%	91.2%	
Prodhimi Bruto i Kaskadës (GWh)	4,125	5,167	3,892	4,512
<i>Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)</i>	91.4%	114.5%	86.3%	

- Për periudhën 2022-2024, viti 2023 ka pasur prurjet më të larta mesatare në Fierzë prej 196 m³/s ose +3.7% më të larta, krahasuar me periudhën 15 vjeçare prej 189 m³/s;
- Po viti 2023 ka rregjistruar prodhimin më të lartë duke gjeneruar bruto 5,167 GWh, ose +14.5% më shumë energji se mesatarja 15 vjeçare;

- Për periudhën 2022-2024, viti 2024 ka patur prurjet më të pakta në Fierzë prej 140 m³/s, ose -26% më të ulta se mesatarja e periudhës 15 vjeçare prej 189 m³/s;
- Prodhimi më i ulët i periudhës 2022-2024, rezulton viti 2022 me gjenerim bruto prej 3,892 GWh, ose -13.7% më i ulët se mesatarja 15 vjeçare.



- Për periudhën 2022-2024, konsumi i ujit/kWh të prodhuar mbetet në tërësi në nivelet e periudhës 15-vjeçare, dukej mbajtur në nivele optimale produktivitetin në gjenerim. Kjo, falë nivelit të lartë të gatishmërisë, cikleve të mirëmbajtjes dhe investimeve rinovuese në HEC-et e kaskadës;
- Gjithashtu, niveli mesatar i shfrytëzimit, qëndron mjaft i përafërt me treguesit respektiv të periudhës

- 15-vjeçare, për të mbajtur ekuilibrin e kombinuar ndërmjet rezervës energjitike dhe prodhimit racional, gjatë ciklit vjetor të operimit të kaskadës;
- Ndërkohë, ngarkesa mesatare e agregateve për periudhën 2022-2024 është më lartë se mesatarja e 15-vjeçare, për të 3 HEC-et e kaskadës, duke treguar që shfrytëzimi i agregateve ka qenë më i lartë në rendiment në pjesën e operim/prodhimit.


TREGUESIT E PERFORMANCËS 2022-2024

Aktiviteti i Tregtisë së Energjisë

KESH sh.a., si kompania e vetme publike e prodhimit dhe njëkohësisht prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në vend, veprimtaria bazë e saj mbetet përmbushja e objektivit për sigurimin e energjisë elektrike për OSSHE Grup, në kuadër të Detyrimit për Shërbim Publik (DSHP) për furnizim e konsumatorëve universal.


- Totali Energji e Tregtuar për 2022-2024 prej 19,634 GWh, me mesatare vjetore prej 6,545 GWh;
- Qarkullimi tregtar më i lartë viti 2023, me 7,036 GWh të shitura;
- Qarkullimi tregtar më i ulët viti 2024, me 6,245 GWh të shitura;

Energji e Tregtuar nga KESH



- Aktiviteti kryesor tregtar mbetet tregu i rregulluar, i cili zë mesatarisht 87% të volumit total vjetor energjetik, me një mesatare vjetore prej 5,683 GWh/vit.


Shitje në kushtet e prurjeve 2022-2024 (MWh & Eur)



TREGUESIT E PERFORMANCËS 2022-2024


- Shitje në treg të lirë në kushtet e prurjeve 2022-2024, në total prej 913,642 MWh, me të ardhura prej 94.6 Mln. Eur (pa TVSH), me çmim të mesatarizuar prej 103.54 Eur/MWh. Viti 2023, me shitjet më të larta prej 639,537 GWh dhe vlerë rreth 56 Mln. Eur.

Aktiviteti i Shërbimeve ndihmëse + Balancimit 2022-2024 (GWh)



- KESH është ofruesi më i madh i shërbimeve ndihmëse dhe balancimit, duke ofruar garanci dhe siguri maksimale në operim jo vetëm për aktivitetin të saj por edhe gjithë sistemit elektroenergjetik Shqiptar dhe atij të Kosovës.

Të Ardhura Neto - Shërbimet Ndihm. /Balanc. 2022-2024 (Mln. Eur) Të ardhura Shitje Kapaciteti rezervë 2022 2024(Mln.Eur)




TREGUESIT E PERFORMANCËS 2022-2024

Përfitueshmëria nga aktiviteti proaktiv dinamik i shërbimeve ndihmëse/balancimit në kushtet e tregut të lirë ka qenë domethënëse. Pjesë e kësaj qasje komerciale janë edhe të ardhurat për rezervim kapaciteti, të cilat në gamën e shërbimeve ndihmëse/balancimit të cilat trajtohen veçantë.

- Gjatë periudhës 2022-2024 është rritur menaxhimi eficient i portofolit optimizues energjetik i orientuar nga sinjalet e çmimeve të tregut. Optimizimi tërësor si në sasi ashtu edhe në vlerë ka qenë mjaft domethënës duke arritur efekt neto financiar përfitueshmërie mbi 65.5 Mln. Eur për këtë 3-vjeçar, me një mesatare vjetore gati 22 Mln. Eur./vit (periudha më e mirë në historinë e KESH), duke e kthyer Korporatën në shoqëri më të orientuar ndaj aktivitetit tregtar.

Optimizimi i Portofolit Ekonomik 2022-2024



Realizimi i Investimeve

- Totali i Investimeve për periudhën 2022-2024 arrin gati 10.32 Mld. Lek, me një mesatare mjaft të lartë prej 3.44 Mld. Lek/vit;
- Viti 2023, kap vlerën maksimale për periudhën 2022-2024 me mbi 3.8 Mld. Lek investime. Vlera më e ulët e periudhës është viti 2022, me mbi 2.75 Mld. Lek investime të realizuara.


VLERA E INVESTIMEVE TË REALIZUARA		2022	2023	2024
Investimet e vetë financuara (Mln. lekë)		2,325	2,675	3,744
Investimet me financim të huaj (Mln. lekë)		427	1,132	17
Total		2,752	3,807	3,761
Investimet sipas Njësive (Mln. lekë)	Fierzë	142	819	261
	Koman	288	138	2,425
	Vau Dejës	531	1,903	656
	Aparati Qendror	1,791	947	419

TREGUESIT E PERFORMANCËS 2022-2024

Fokusi i investimeve sipas fushave

- Fusha e Rritjes së efijencës/cilësisë së prodhimit, ku për 2022-2024, investimet arrijnë në 6.27 Mld. Lek (61% e totalit të investimeve), duke përbërë edhe fushën kryesore të investimeve. Këtu përfshihen edhe investimet në BRE;
- Fusha e sigurisë së veprave gjeneruese, ku për 2022-2024, investimet arrijnë gati 3 Mld. Lek (29% e totalit të investimeve);
- Fusha e Përmirësimit të kushteve të punës, ku për 2022-2024, investimet arrijnë mbi 1.05 Mld. Lek (10% e totalit të investimeve)


Realizimi i Investimeve sipas Fushës (në Mijë Lek)



Burimet e financimit të investimeve

- Investimet me fondet e veta të KESH, për 2022-2024, arrijnë në 8.74 Mld. Lek (85% e totalit të investimeve), duke mbajtur peshën dërrmuese të shpenzimeve kapitale;
- Investimet me financim të huaj, për 2022-2024, arrijnë në gati 1.58 Mld. Lek (15% e totalit të investimeve).

Investimet e Realizuara sipas Burimit të Financimit (në Mln. Lek)




TREGUESIT E PERFORMANCËS 2022-2024

Investimet sipas njësive

Gjatë periudhës 2022-2024, investimet në HEC Vau i Dejës dhe KESH Qendër arrijnë me nga 30% secila, ndaj totalit, ndjekur nga HEC Koman me 28% dhe HEC Fierzë me 12%.

INVESTIMET SIPAS NJËSIVE 2022-2024 (MLN. LEK DHE %)



Gjatë periudhës 2022-2024, investimet kryesore janë:

- Përmbyllja e Projektit të “Sigurisë së Veprave Hidrike”;
- Investime rinovuese në linjat elektro-mekanike dhe sistemet e monitorim kontrollit në HEC-e;
- Investime në fushën e TIK dhe sigurisë kibernetike;
- Investimi në rehabilitimin e rrugës Qafë Qelë – Koman me impakt të ndjeshëm në lidhjen ndërmjet HEC Vau i Dejës- HEC Koman.

Roli i Partnerëve Ndërkombëtarë

Siguria e digave është një element thelbësor për funksionimin e qëndrueshëm të sistemit elektroenergjetik të vendit dhe për mbrojtjen e komuniteteve që jetojnë pranë veprave hidrike. Në kushtet kur Shqipëria mbështet pjesën më të madhe të prodhimit të energjisë mbi burimet hidrike, mirëmbajtja dhe modernizimi i digave përfaqëson një prioritet kombëtar. Çdo problematikë teknike në këto struktura mund të shkaktojë pasoja të mëdha jo vetëm për prodhimin e energjisë, por edhe për mjedisin dhe sigurinë e qytetarëve. Nisur nga kjo rëndësi, KESH ka vënë në qendër të vizionit të tij zhvillues Projektin e Sigurisë së Digave, i cili mbështetet financiarisht nga partnerë të fuqishëm ndërkombëtarë dhe synon të garantojë standardet më të larta të sigurisë, monitorimit dhe mirëmbajtjes së veprave hidrike.

Përmbledhje e projektit

Ky projekt me rëndësi prioritare financohet nga Banka Botërore (WB), Sekretariati Shtetëror i Bashkëpunimit Financiar Zvicerian (SECO), Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Gjermane për Zhvillim (KfW). Objektivat kryesore lidhen me:

- rritjen e sigurisë së digave në kaskadat e Drinit dhe Matit,
- garantimin e një furnizimi të qëndrueshëm me energji elektrike,
- rritjen e eficiencës së prodhimit nga burimet hidrike,
- forcimin e rolit të Shqipërisë në tregun rajonal të energjisë.

TREGUESIT E PERFORMANCËS 2022-2024

Kontributet e institucioneve financiare ndërkombëtare

- **Banka Botërore** ka financuar rehabilitimin e portave në HEC Fierzë e Koman, supervizimin e punimeve nga kompania zvicerane AF Consult, menaxhimin financiar nga Deloitte Albania & Deloitte Romania dhe ngritjen e një paneli ekspertësh të pavarur ndërkombëtarë për miratimin e ndërhyrjeve me ndikim në sigurinë e digave.
- **SECO** ka financuar pajisjen e kaskadave të Drinit dhe Matit me sisteme të monitorimit sizmik, gjeologjik dhe gjeodetik, si dhe masat mbrojtëse ndaj rrezikut të rënies së shkëmbinjve në HEC Fierzë.
- **BERZH** ka kontribuar në rehabilitimin e portave të shkarkimit në HEC Koman dhe ka bashkëfinancuar me Bankën Botërore ndërhyrjet në Fierzë e Koman.
- **KfW** ka financuar rehabilitimin e portave në HEC Vau i Dejës dhe ngritjen e Qendrës së Kontroll-Monitorimit të kaskadës së Drinit, duke siguruar një sistem modern dhe të centralizuar të mbikëqyrjes. Së fundmi, është rënë dakord për financimin e projektit madhor “Rehabilitimi Elektro-Mekanik i HEC Fierzë” në vlerën 100,47 milion euro, i cili pritet të nisë pas ratifikimit nga Parlamenti.

Rezultatet e deritanishme

Falë këtyre investimeve, një pjesë e madhe e punimeve rehabilituese është përfunduar me sukses, duke garantuar funksionimin e sigurt të portave të shkarkimit dhe mirëmbajtjes, modernizimin e sistemeve të monitorimit dhe ngritjen e një infrastrukture të re kontrolli për kaskadën e Drinit. Ky progres përbën një hap të madh drejt garantimit të sigurisë së plotë të veprave hidrike dhe forcimit të besueshmërisë së sistemit elektroenergjetik.

Perspektiva

Në fazën e ardhshme, theksi do të vihet mbi rehabilitimin elektro-mekanik të HEC Fierzë, një projekt i cili do të rrisë më tej eficiencën dhe jetëgjatësinë e turbinave, duke siguruar vazhdimësinë e prodhimit të energjisë hidrike në standardet më të larta të sigurisë. Kjo qasje konfirmon vizionin e KESH për të garantuar jo vetëm prodhimin e energjisë, por edhe mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë e komuniteteve, duke e pozicionuar Shqipërinë si një shembull në rajon për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe energjetike.

Dimensioni Social – Mjedor



Gjatë viteve 2022–2024, KESH ka dëshmuar përkushtim për të balancuar zhvillimin ekonomik me mbrojtjen e mjedisit dhe mbështetjen e komuniteteve lokale. Kompania ka investuar në impiante fotovoltaike, ka përmirësuar menaxhimin e mbetjeve dhe ka forcuar monitorimin e cilësisë së ujit dhe ajrit, duke reduktuar ndikimet mjedisore dhe duke kontribuar në diversifikimin e burimeve të energjisë.

Në planin social, KESH ka zhvilluar projekte të shumta për sigurinë dhe shëndetin në punë, edukimin mjedor, arsimin dhe kulturën. Stafi ka përfituar trajnime të vazhdueshme, ndërsa komunitetet lokale janë mbështetur me investime infrastrukturore, aktivitete kulturore dhe fushata sensibilizuese për eficiencën e energjisë dhe përdorimin e burimeve të pastra.

TREGUESIT E PERFORMANCËS 2022-2024

Transparenca dhe dialogu me palët e interesit janë forcuar përmes takimeve publike dhe mekanizmave të komunikimit të drejtpërdrejtë, duke ndërtuar besim dhe bashkëpunim afatgjatë. Për të ardhmen, KESH planifikon zgjerimin e investimeve në burime të rinovueshme si energjia diellore dhe ajo me erë, integrimin e standardeve ESG dhe përdorimin e teknologjive të avancuara, duke synuar të jetë një model i zhvillimit të qëndrueshëm në sektorin energjetik shqiptar dhe rajonal.

TABELAT PËRMBLEDHËSE E NISMAVE SOCIAL – MJEDISORE



TREGUESIT EKONOMIKO-FINANCIAR

Periudha 2022-2024, ka rezultuar me tablo të ndryshme ekonomiko-financiare. Kjo për shkak të gjendjes së emergjencës në furnizimin e energjisë elektrike gjatë viteve 2022-2023, si pasojë e krizës globale e energjisë, shkaktuar nga konflikti Rusi-Ukrainë. Rritja e pazakontë e çmimeve ndërkombëtare të energjisë, ekspozoi Korporatën ndaj importeve të shtrenjta në vite të thata si 2022. Ndërkohë në vite hidrike pozitive si 2023, shpaloset aktivitet mjaft pozitiv, si rezultat i shitjeve të energjisë elektrike me çmime të larta.

Treguesit Ekonomik kryesor 2022-2024

Treguesit e Aktivitetit Ekonomik	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022	Mesatarja 5-vjeçare (2020-2024)
Energjia Neto e Prodhuar nga KESH sh.a (GWh)	4,115	5,131	3,860	4,308
Të Ardhura ('000 Lekë)¹	26,288,770	38,366,097	36,609,329	26,307,104
Energji elektrike ('000 Lekë)	20,130,182	32,519,044	29,944,816	20,498,939
Shërbimet ndihmëse dhe të balancimit ('000 Lekë)	4,898,832	4,623,231	5,260,934	3,847,334
Të ardhura të tjera ('000 Lekë)	1,259,757	1,223,823	1,403,579	1,960,831
Fitimi / (Humbja) neto për periudhën ('000 Lekë)	-378,718	17,053,377	-25,818,100	-210,568
Llogari të Pagueshme ('000 Lekë)	6,142,813	22,801,193	25,332,173	26,364,082
Llogari të Arkëtueshme ('000 Lekë)	64,226,152	75,745,231	72,685,314	66,547,605
Shpenzimet Fikse Operacionale ('000 Lekë)²	2,355,998	2,311,134	2,295,441	2,246,024
Shpenzime Operative ('000 Lekë/GWh)	573	450	595	539

- Për periudhën 2022-2024, mesatarja e treguesit Shpenzime operacionale/GWh të prodhuar prej 539,000 Lek/GWh ka ruajtur trendin 5-vjeçar 2020-2024. Kjo, si rezultat i qasjes kost-kontroll nëpërmjet menaxhimit eficient të shpenzimeve të përgjithshme të aktivitetit të operacioneve të vijueshëm;
- Për periudhën 2022-2024, pavarësisht vlerës ende të lartë, Llogaritë e Arkëtueshme kanë shënuar trend ulës, veçanërisht gjatë 2023-2024, nga 75.75 Mld. Lek ato ranë në 64.23 Mld. Lek, me ulje të ndjeshme prej -11.52 Mld. Lek (-15.2%), duke ndikuar pozitivisht në nivelin e likuiditeteve të Korporatës;
- Për periudhën 2022-2024, Llogaritë e Pagueshme janë ulur ndjeshëm, nga 25.33 Mld. Lek në 2022, janë reduktuar në vetëm 6.14 Mld. Lek. Kjo, si rezultat i rritjes së aftësisë paguese dhe qasjes korrekte të Korporatës ndaj shlyerjes së detyrimeve, në marrëdhëniet me palët e treta, si rezultat i përpjekjeve intensive në drejtim të konsolidimit të mëtejshëm ekonomiko-financiar.

Gjatë periudhës 2022-2024, si rezultat i ristrukturimit të borxhit afatshkurtër, ka dhënë efekte shumë pozitiv, sidomos të pozicionin e detyrimeve financiare afatshkurtër, duke i ulur ndjeshëm ato.

TREGUESIT EKONOMIKO-FINANCIAR

Ovderdrafet dhe Normat e Interesit	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022	Mesatarja 5-vjeçare (2020-2024)
Totali i Huave të b.vlefshme ('000 Lekë)	5,544,242	5,665,459	6,003,291	5,899,866
Norma Mesatare e Interesave	1.51%	2.22%	3.21%	3.18%
Shpenzimet për Interesa ('000 Lekë)	83,728	126,036	192,817	187,698

- Detyrimet financiare afatshkurtra (kryesisht overdraftet) janë ulur në 5.5 Mld. Lek në fund të 2024;
- Norma e mesatare interesave nga 3.21% në 2022, janë ulur në 1.51% në fund të 2024;
- Rrjedhimisht, shpenzimet për interesa të borxhit afatshkurtër janë reduktuar ndjeshëm nga 193 Mln. Lek në 2022, në 83.7 Mln. Lek në 2024.

Edhe në aspektin fiskal, gjatë periudhës 2022-2024, vërehet një performancë pozitive, pasi Korporata si rezultat i konsolidimit të vazhdueshëm ekonomik-financiar po përmbush me përgjegjësi detyrimet ndaj fiskut, duke kontribuar maksimalisht në buxhetin e shtetit:

Pagesat e Detyrimeve Tatimore ('000 Lekë)	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022	Mesatarja 5-vjeçare (2020-2024)
TVSH paguar te tatimet	0	-	2,174	575,360
Tatim fitimi	3,140,874.66	1,150,010	304,230	1,585,026
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	362,206.82	361,180	340,217	341,952
Taksa/Tarifa të tjera-Tatim në Burim	13,021.11	1,811	1,425	4,718
TOTAL	3,516,102.58	1,513,000	648,047	2,507,056

- Përgjatë periudhës 2022-2024, pagesat e detyrimeve fiskale kanë rezultuar në rritje të konsiderueshme. Nga 0.65 Mld. Lek në 2022, ato kanë arritur në mbi 3.51 Mld. Lek në 2024, duke u rritur me 5.4 herë. Vetëm tatim fitimi gjatë 2024 janë paguar 3.14 Mld. Lek, duke zënë 89% të totalit të pagesave fiskale.

